

KONTRATË

“MBI THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË”

“E & M 2021”

Sot më datë 10.11.2021, Anëtarët Themelues :

1. z. Mikele Bekteshi, i biri i Engjëllush, lindur më 24.10.1997 dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga “Sulejman Pasha”, Ap. 33, Tiranë.
2. zj. Eri Bekteshi, e bija e Engjëllush, lindur më 10.03.2002 dhe banuese në Tiranë, me adresë Rruga “Sulejman Pasha”, Ap. 33, Tiranë.

Së bashku me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet këtij Statuti, bien dakort për krijimin e Shoqërisë së Thjeshtë “E & M 2021” me kushtet e përcaktuara në këtë akt.

TË PËRGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anëtarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

NENI 1

Shoqëria e Thjeshtë “E & M 2021” themelohet si një shoqëri e thjeshtë, bazuar në dispozitat e neneve 1074-1112 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ndryshimeve që mund të pësojnë këto dispozita në të ardhmen.

Shoqëria e thjeshtë është person juridik privat.

Selia e saj ndodhet në adresën : Rruga “Sulejman Pasha”, Ap. 33, Tiranë; Tel” +355 69 73 05 467; Email : erimikele962@yahoo.com.

NENI 2

Veprimtaria e shoqërisë bazohet në standartet e kësaj Kontrate Themelimi, Statutit të shoqërisë, si edhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Themeluesit e shoqërisë mbajnë përgjegjësi për detyrimet që krijon shoqëria e thjeshtë.





NENI 3

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 1.000 (një mijë) lekë.

Kapitali themeltuar është investuar nga Anëtarët e shoqërisë në mënyrën si më poshtë :

1. z. Mikele Bekteshi në masën 50 % të vlerës së kapitalit.
2. zj. Eri Bekteshi në masën 50 % të vlerës së kapitalit.

Vlerëimi i kapitalit themeltar është bërë nga anëtarët themelues me rastin e themelimit të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre.

NENI 4

Shoqëria ka depozituar në bankën Raiffeisen Sha në Tiranë, kapitalin në të holla, i cili depozitohet në llogarinë e Shoqërisë së Thjeshtë "E & M 2021" në datën e paraqitjes për regjistrim të kësaj kontrate themelimi.

Pas regjistrimit të shoqërisë së thjeshtë kjo shumë do të depozitohet në llogarinë e shoqërisë së re pranë të njëjtës bankë

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria e Thjeshtë "E & M 2021" do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj :

- Dhënien e konsulencës në fushën e jurisprudencës, redaktimin e kontratave të të gjitha llojeve dhe ndjekjen e tyre deri në zbatim.
- Auditim, mbikëqyrje për kontratat në aspektin juridik, këshillime, konsulencë juridike.
- Mbikëqyrje e kompanive nga krijimi i tyre deri në zbatimin e aktivitetit për të cilin janë krijuar. Redaktim të kontratave të punës të punonjësve etj.
- Dhënie ndihme juridike për negocimin, hartimin, lidhjen dhe zbatimin e kontratave civile, tregtare, administrative dhe për veprime të tjera juridike.
- Ofrimin e çdo lloj konsulence kundrejt personave juridike dhe fizikë, vendas apo të huaj, organizma tregtare, organizatat jo fitimprurëse, fondacionet, departamentet qeveritare etj. Konsulencë në lidhje me çështjet organizative, administrimin e biznesit, menazhimin, marketingun, konsulencë për taksat dhe tatimet si dhe planifikimin e përgjithshëm të tyre, burimet njerëzore etj.
- Konsulencë për administrimin, shitblerjen, shënien me qira të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, të veprave civile, tregtare, industriale etj.



NENI 6

Shoqëria e thjeshtë do të ushtrojë aktivitetin e saj me një afat kohor të pakufizuar në kohë. Veprimtaria e shoqërisë do të fillojë menjëherë pas regjistrimit të shoqërisë "E & M 2021" në Qendrën Kombëtare të Biznesit/Regjistrimit.

NENI 7

Fitimi i realizuar do të shpërndahet midis anëtarëve themelues të shoqërisë. Fitimi i realizuar është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë shtetit shqiptar.

NENI 8

Anëtarët themelues, ndër të tjera kanë detyrimet :

- Të regjistrojnë (së bashku ose veç e veç) shoqërinë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Të depozitojnë kapitalin e nevojshëm për fillimin e aktivitetit të shoqërisë.
- Të sigurojnë ambjentet e nevojshme dhe domosdoshme për fillimin e aktivitetit, infrastrukturën e nevojshme teknike dhe operative.
- Të sigurojnë kushtet për specializimin dhe rritjen profesionale të anëtarëve dhe stafit me qëllim dhënien e shërbimeve në një cilësi dhe kapacitet maksimal.
- Të menaxhojnë me efikasitet dhe cilësi marketingun dhe reklamimin e shoqërisë dhe klientëve të saj, përmes rrjeteve të ndryshme të informacionit.

NENI 9

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e Anëtarëve të Shoqërisë;
- Administratorët e Shoqërisë;

Mënyra e veprimtarisë së tyre, janë përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 10

Anëtarët Themelues si dhe të gjithë anëtarët që do të pranohen si të tillë në shoqëri duke përfshirë edhe partnerët apo bashkëpunëtorët e saj, detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së shoqërisë.



Të punësuarit dhe të ngarkuarit me menaxhimin e shoqërisë, apo të ngarkuarit për kryerjen e porosive të veçanta sipas nevojave të shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen që të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Në rast se linden mosmarrëveshje mbi këtë akt themelimi (kontratë themelimi), anëtarët do t'i zgjidhin ato me bisedime dhe mirëkuptim. Nëse kjo nuk arrihet, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Kontrata pasu u lexua nga Anëtarët Themelues, u gjend e rregullt dhe në përputhje me vullnetin e tyre, duke u nënshkruar më pas.

ANËTARËT THEMELUES

MIKELE BEKTESHI

Mikela Bekteshi

MB

ERI BEKTESHI

Eri Bekteshi